



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

PROVIMI ME ZGJEDHJE I MATURËS SHTETËRORE 2016
SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

Lënda: Qytetari

Varianti A dhe B

Udhëzime të përgjithshme

- Testi përmban në total 40 pikë.
- Testi ka 20 pyetje: 10 me zgjedhje dhe 10 me zhvillim.
- Për pyetjet me zgjedhje përgjigjja e saktë vlerësohet me një pikë.
- Për pyetjet me zhvillim janë dhënë modele përgjigjesh të sakta.

Shënim:

- Në skemën e vlerësimit të testit, për pyetjet me zhvillim janë dhënë modele përgjigjesh të sakta. Nxënësi do të marrë pikët e merituar edhe nëse ai ka dhënë përgjigje me fjalë të tjera por që janë brenda kontekstit të përgjigjes së saktë.
- Në pyetjet me zhvillim, ku kërkohen dy, tre apo katër nga të gjitha përgjigjet e sakta të mundshme, në rast se nxënësi ka dhënë aq përgjigje të sakta sa i kërkohen nga pyetja, atëherë atij do t'i jepen të gjitha pikët maksimale me të cilat është vlerësuar pyetja.
- Nxënësi do të marrë aq pikë sa është vlerësuar pyetja edhe në rast se ai ka dhënë më shumë përgjigje të sakta nga sa i kërkohen.
- Nxënësi merr pikë duke dhënë përgjigje sipas formimit të tij edhe nga lëndët e tjera. Kalimi nga njëra pikë te tjetra e një problemi nuk e ndëshkon në pikëzim, pasi ato lidhen me njëri-tjetrin

Pyetjet me zgjedhje

Numri i Pyetjes	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Përgjigje e saktë varianti A	B	A	C	B	B	D	B	B	A	C
Përgjigje e saktë varianti B	D	B	B	A	C	B	A	C	B	B

Varianti A

Varianti B pyetja nr.

1. B) shteti nuk trajton me përparësi një fe të veçantë; 6
2. A) Riprodhues; 7
3. C) 18 vjeç, sepse është e miratuar ndërkombëtarisht; 8
4. B) dinjitet; 9
5. B) bashkëpunimi pushtet qendror dhe vendor; 10
6. D) ndalon kultivimin, tregtimin dhe transportimin e tyre. 1
7. B) shteti dhe institucionet shkencore; 2
8. B) Kostoja e fshehur e saj; 3
9. A) ishin të detyruar t'i binden sinjalit të policit; 4
10. C) të marrin informacion, ta botojnë atë dhe të kritikojnë; 5

Pyetjet me zhvillim11. **3 pikë** varianti A

pyetja nr 17 varianti B

- a) çdo shtetas është i lirë të votojë ose jo/të votojë me vullnetin e tij të lirë duke respektuar ligjin/të zgjidhet ose të zgjedhë/ të votojë pa u kërcënuar-(pa presion)/Kërkesa kryesore e këtij parimi është sigurimi i kushteve dhe garancive për të mundësuar shprehjen e lirë të vullnetit të zgjedhësve./ përfshirjen në zgjedhje të të gjithë atyre që kanë mbushur moshën e caktuar me ligj/18 vjeç.
- b) vota e çdo shtetasi ka vlerë të barabartë pa asnjë dallim(race/feje/gjinie/pozite shoqërore, etj.) Parimi i zgjedhjeve të barabarta bazohet në parimin e përgjithshëm kushtetues të barazisë së shtetasve para ligjit.
- c) zgjedhjet periodike janë kusht i domosdoshëm për mbarëvajtjen e demokracisë në vend./ Ato garantojnë detyrimin që zgjedhjet të zhvillohen pas intervaleve periodike të kohës,/ periodiciteti u jep mundësi të gjitha forcave politike të marrin pushtetin dhe zgjedhësve të kontrollojnë veprimtarinë e tyre.

Nxënësi fiton:**3 pikë** Nëse shkruan nga një aspekt nga thelbi i parimit kushtetues, sipas kërkesave a), b) dhe c);**OSE****2 pikë** Nëse shkruan dy aspekte nga thelbi i parimit kushtetues për dy prej kërkesave;**1 pikë** Nëse shkruan një aspekt nga thelbi i parimit kushtetues për një prej kërkesave;**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.12. **2 pikë** varianti A

pyetja nr 18 varianti B

- a) *shoqëria agrare*- lindnin shumë fëmijë sepse duheshin për krahë pune /kujdesi kryesor ndaj tyre ishte ushqimi/nuk gëzonin të drejta për moshën që kishin;
shoqëria e urbanizuar-numri i vogël i fëmijëve/ problem është edukimi/integrimi/kuadri ligjor kombëtar e ndërkombëtar në mbrojtje të fëmijëve etj.;

b)

- shoqëria agrare*- mosha e ulët e martesës/puna brenda ekonomisë shtëpiake/ pamundësia për karrierë/ të drejta të kufizuara;
shoqëria e urbanizuar – rritja e moshës së martesës/ rritja e arsimimit/rritja e punësimit jashtë ekonomisë shtëpiake/rritja e shkallës së barazisë gjinore/përmirësimi i statusit shoqëror dhe familjar/ përparimi në karrierë etj.

Nxënësi fiton:**2 pikë** Nëse shkruan një ndryshim lidhur me rolin e fëmijëve dhe një ndryshim lidhur me rolin e gruas;**OSE****1 pikë** Nëse shkruan një ndryshim lidhur me rolin e fëmijëve;**OSE** Nëse shkruan një ndryshim lidhur me pozitën e gruas;**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.13. **4 pikë** varianti A

pyetja nr 19 varianti B

- arsimon/edukon e brezin e ri;
- transmeton dije;
- formon/ zhvillon personalitetin/dinjitetin njerëzor/karakterin e fëmijës/nxënësit;
- ngre vetëdijen/integrimin për vlerat kombëtare, si patriotizmi/atdhedashuria/fqinjësia e mirë/toleranca ndaj tjetrit për fenë/kulturën/origjinën/fetar/etnik/racor,etj.
- edukon vlera/qëndrime;
- hap rrugën për të gjithë gjeneratat e reja drejt një të ardhmje më të mirë;
- kultivon aftësi individuale të nxënësve;
- vë në lëvizje/ekuilibron botët e komplikuara të fëmijëve në formim;
- nxit natyrën e lirë/të pavarur/ të nxënësit;
- formon qytetarin aktiv/vendimmarrës/ kritik/bashkëpunues në grup/me respekt ndaj tjetrit;
- udhëheq drejt autonomisë/pavarësisë/karrierës/profesionit etj.
- është udhërrëfyes/ edukator/drejtues;

- ndihmon në emancipim /zhvillim social/ekonomik/shpirtëror;
- realizon potencialet njerëzore të nxënësi;
- jep njohuri/dije/shprehi/kompetenca;
- edukon ndërgjegjen/norma morale/etike/ligjore;
- etj.

Nxënësi fiton:

4 pikë Nëse shkruan katër elemente të misionit të mësuesit;

3 pikë Nëse shkruan tre elemente të misionit të mësuesit;

OSE

2 pikë Nëse shkruan dy elemente të misionit të mësuesit;

1 pikë Nëse shkruan një element të misionit të mësuesit;

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

14. **3 pikë** varianti A

pyetja nr 20 varianti B

- cënon edukimin;
- dëmton shëndetin;
- dëmton zhvillimin e tij fizik;
- dëmton shëndetin mendor, shpirtëror, moral ose shoqëror;
- cënon lirinë;
- pengon procesin e shoqërizimit me moshatarët;
- frenon argëtimin/kohën e lirë/pasionin për lojën, etj

Nxënësi fiton:

3 pikë Nëse shkruan tre pasoja;

OSE

2 pikë Nëse shkruan dy pasoja;

1 pikë Nëse shkruan një pasojë;

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

15. **3 pikë** varianti A

pyetja nr 11 varianti B

- parandalon krimet/kundravajtjet;
- rregullon marrëdhëniet juridike/civile/administrative/familjare/të punës;
- nxit zhvillimin e gjithanshëm të shoqërisë;
- rregullon qarkullimin rrugor;
- nxit sjelljet shoqërore pozitive;
- harmonizon veprimtaritë njerëzore në të gjitha fushat;
- kontrollon veprimtarinë njerëzore në fusha të ndryshme, etj.

Nxënësi fiton:

3 pikë Nëse shkruan tre aspekte të domosdoshmërisë së ligjeve në shoqëri;

OSE

2 pikë Nëse shkruan dy aspekte të domosdoshmërisë së ligjeve në shoqëri;

1 pikë Nëse shkruan një aspekt të domosdoshmërisë së ligjeve në shoqëri ;

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

16. **4 pikë** varianti A

pyetja nr 12 varianti B

Të rriturit mendojnë (paragjykojnë) se të rinjtë:

- janë të papërgjegjshëm për pasojat e veprimeve dhe vendimeve të tyre;
- nuk orientohen nga e ardhmja e tyre në vendimmarrjen e tyre;
- marrin vendime pa u përpjekur të marrin informacion të plotë paraprak;
- janë rebelë;
- kanë të njëjtat probleme dhe shqetësime si të të rriturve;

- gabojnë gjithmonë në vendimmarrje;
 - nuk mësojnë/ nuk punojnë/nuk angazhohen/ nuk dinë të vlerësojnë paratë/janë dembelë etj.
 - e kanë mendjen vetëm tek dëfrimi;
 - janë të pasigurt për jetën;
 - janë të paaftë për sukses;
 - nuk mendojnë për prindërit;
 - të rinjtë nuk janë pjesë e botës së prindërve, etj.
- Shënim: nuk merr pikë nëse shkruan pasojat e këtyre paragjytimeve.

Nxënësi fiton:

4 pikë Nëse shkruan katër paragjytime;

OSE

3 pikë Nëse shkruan tre paragjytime;

2 pikë Nëse shkruan dy paragjytime;

1 pikë Nëse shkruan një paragjytime;

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

17. **2 pikë** varianti A pyetja nr 13 varianti B

- a) çrregullim serioz/torturë pa ngrënë deri në vdekje për të qenë elegant/të paaftë për të njohur nevojat për ushqim/kënaqen me peshën e tyre, por dëshirojnë të vazhdojnë dobësimin/ dëshirë e egzagjeruar për të qenë i dobët/e quajnë veten shumë të trashë/ preferojnë fruta dhe perime/evitojnë sheqernat/mishin/gjellën....
- b) bulimia- nuk humbin shumë peshë/janë pak mbipeshë/konsumojnë shumë karbohidrate/kanë shumë uri për ëmbëlsira/kripëra/tentojnë ta nxjerrin ushqimin e ngrënë me tepicw;
- shënim: nuk merr pikë nëse shkruan pasojat e sëmundjeve të sipërpërmendura

Nxënësi fiton:

2 pikë Nëse shkruan një veçori të anoreksisë dhe një të bulimisë .

OSE

1 pikë Nëse shkruan një veçori të anoreksisë.

OSE Nëse shkruan një veçori të bulimisë.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

18. **3 pikë** varianti A pyetja nr 14 varianti B

- a) infrastruktura/ rregullim i atyre ekzistuese dhe ndërtimi i të reja-spitale/ klinika/ ambulanca/aparatura, mirëmbajtja e mjedisit/ fuqizimi i qendrave spitalore/përmirësimi i kapaciteteve profesionale/ fuqizimi me pajisje/përmirësimi i kapaciteteve menaxheriale për një shërbim sa më të mirë;
- b) profesionalizmi/ etika komunikimi qytetar/ devotshmëria/kujdesi/përkushtimi/moskorrupsioni; specializimi/vetkualifikimi/vullneti për të vënë në shërbim profesionalizmin/përvoja profesionale etj.

Nxënësi fiton:

3 pikë Nëse shkruan dy objektiva për institucionet shëndetësore dhe një për stafin e shërbimit;

2 pikë Nëse shkruan një objektiv për institucionet shëndetësore dhe një për stafin e shërbimit;

OSE

1 pikë Nëse shkruan një objektiv për institucionet shëndetësore;

OSE Nëse shkruan një objektiv për stafin e shërbimit;

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

19. **2 pikë** varianti A pyetja nr 15 varianti B

a) kalim mbitokësor;

b)

➤ të mos kalojë në anën tjetër të rrugës nga karexhata, por te mbikalimi;

➤ të sigurohet se mbikalimi funksionon si duhet.

Nxënësi fiton:

2 pikë Nëse shkruan kuptimin e shenjës së kodit rrugor dhe një nga rregullat e mësipërme;

OSE

1 pikë Nëse shkruan kuptimin e shenjës së kodit rrugor;

OSE Nëse shkruan një nga rregullat e mësipërme;

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

20. **4 pikë** varianti A

pyetja nr 16 varianti B

- marrja e informacionit në fusha të ndryshme/në kohë të shkurtër;
- mjet marketingu, reklamash, blerjesh. etj.
- zgjerimi i rrethit shoqëror;
- kontakte të shpeshta/të shpejta me tjerët;
- kursimi i kohës fizike në marrjen e kontakteve;
- mjet argëtimi, zbavitjeje;
- ndërthurje mes kulturash, etj.

Nxënësi fiton:

4 pikë Nëse shkruan katër efekte;

OSE

3 pikë Nëse shkruan tre efekte;

2 pikë Nëse shkruan dy efekte;

1 pikë Nëse shkruan një efekt;

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.